

Drejtuar: adobrushshi@osfa.soros.al; kristina.voko@birn.eu.com; seda@adanet.com.al; genemyftiu@hotmail.com; gadeshi@hotmail.com; info@institutip3.com; edithharxhi@yahoo.co.uk; Aranita.brahaj@ais.al; Ardian.hackaj@cdinstitute.eu; plan@co-plan.org; arakipi@aiis-albania.org; zef.preci@gmail.com; idra@idracompany.com; elira.jorgoni@gmail.com; gadc@gadc.org.al; marqimandriti@gadc.org.al; aid.tirana@gmail.com; blerina.celoaliaj@savethechildren.org; info.albania@savethechildren.org; okullolli@sustainablefinance.al; indritseferi@gmail.com

Në emër të Ministrisë së Financave,

Ju njoftojmë se ka nisur procesi për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership-OGP) 2026-2030.

Partneriteti për Qeverisje të Hapur është një nismë vullnetare ndërkombëtare që synon të sigurojë angazhime të qeverive në promovim të transparencës, fuqizimit të qytetarëve, luftës ndaj korrupsionit, dhe përdorimin e teknologjive të reja për forcimin e qeverisjes.

Një element thelbësor i këtij procesi është bashkëkrijimi, ku institucionet, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe palët e tjera të interesuara (qytetarët, sektori privat, akademikët) **punojnë së bashku për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të veprimit**. Bashkëkrijimi siguron që reformat të zhvillohen së bashku dhe të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përgjigjen ndaj nevojave të qytetarëve, në vend që të krijohen vetëm nga autoritetet.

Ministria e Financave shpall për konsultim të hapur me institucionet publike, Organizatat e Shoqërisë Civile, grupet e interesit dhe publikun e gjerë **pyetësin paraprak për konceptimin e masave prioritare**, në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur për periudhën 2026-2030. Pyetësin e gjeni në linkun në vijim: [Ministria e Financave](#)

Mirëpresim çdo propozim për masat prioritare në fushën e transparencës buxhetore, të të ardhurave apo të financave publike, që vlerësoni të nevojshme për t'u ndërmarrë në kuadër të këtij plani.

Ministria e Financave mirëpret kontributet e të gjithë bashkëpunëtorëve në këtë proces bashkëkrijimi, **deri më datë 17 mars 2026**.

Pyetësi i plotësuar duhet të dërgohet në adresën: pfm.unit@financa.gov.al

Në këtë kuadër, Ministria e Financave, do të organizojë një takim të përbashkët me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe përfaqësues nga Ministria e Financave, si institucioni koordinues i procesit, për të prezantuar hapat teknikë të hartimit të planit, do të diskutohen fushat e përfshira dhe do të shkëmbehen mendime dhe kontribute nga aktorët e interesuar.

Takimi do të zhvillohet **ditën e premte në orën 10:00, tek Salla e katit te katert** në Ministrinë e Financave

Lutem gjeni bashkëlidhur axhendën e takimit.

Lutem sigurimin e pjesëmarrjes tuaj në takim.

Çdo kontribut i Juaji është i vlefshëm në këtë proces.

Me respekt!